

**UNIVERSITETI I SHKODRËS**  
**«LUIGJ GURAKUQI»**



*Shkodër, tetor 2009*

## **P A S Q Y R A   E   L Ë N D Ë S**

<b>Kreu I: Dispozita të përgjithshm .....</b>	<b>2</b>
<b>Kreu II. Pranimet në USH .....</b>	<b>4</b>
<b>Kreu III: Organizimi i studimeve .....</b>	<b>7</b>
<b>Kreu IV: Kontrolli i dijeve .....</b>	<b>16</b>
<b>Kreu V: Diplomimi .....</b>	<b>23</b>
<b>Kreu VI: Të drejtat e detyrimet e studentit .....</b>	<b>26</b>
<b>Kreu VII: Dispozita të veçanta .....</b>	<b>28</b>

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

“Rregullorja e studimeve” e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” mbështetet në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (indryshuar) dhe në Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

#### **Neni 2**

Kjo rregullore e shtrin efektin e saj në të gjithë veprimitarë akademike të USH.

#### **Neni 3**

##### **Sistemi i studimeve**

1. Studimet në USH organizohen në këto sisteme :
  - me kohë të plotë,
  - me kohë të pjesshme,
  - në distancë.
2. Studentët e çdo sistemi studimi nuk mund t'i kryejnë studimet në një afat më të shkurtër se ai i parashikuar në planin mësimor.

#### **Neni 4**

##### **Ciklet e studimit dhe afatet e tyre**

1. Programet e studimeve në USH organizohen në tre cikle të

njëpasnjëshme :

- a. **Studime të ciklit të parë.** Ofrojnë njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në një varietet të gjerë profesionesh e specialitetesh. Realizohen me 180 kredite dhe zgjatja e tyre është tre vite. Në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP) në fushën përkatëse të arsimimit.
- b. **Studime të ciklit të dytë.** Ato ndahen në :
  - “Master i nivelit të parë”. Ofron arsimim dhe trajnim të mëtejshëm profesional. Realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit. Në përfundim të tyre lëshohet diploma “Master i nivelit të parë”
  - **Diplomë e nivelit të dytë.** Ofron njohuri të thelluara teorike apo praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë të caktuar brenda një specialiteti. Realizohet me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite. Në përfundim të tyre lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë” në fushën e arsimimit të kryer.
- c. **Studime të ciklit të tretë.** Ato ndahen në :
  - **Programe të studimit të doktoratës.** Janë programe me karakter plotësisht akademik, që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimitari krijuese të pavarura. Zgjasin të paktën 3 vite dhe përfshijnë edhe 60 kredite për studime të organizuara. Në përfundim të tyre lëshohet diploma “Doktor i shkencave”
  - **Programet e studimeve “Master i Nivelit të Dytë”.** Ofron arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë shkencor ose profesional. Realizohet me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është minimumi një vit. Në përfundim të studimeve jepet diploma “Master i Nivelit të Dytë”
- d. USH ka të drejtë të ofrojë edhe programe **studimi jouniversitarë**, të natyrës profesionale, me jo më pak se 120 kredite. Zgjatja normale e këtyre programeve studimi është jo

më pak se 2 vite akademike dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë e veçantë.

2. Për çdo cikël të veçantë studimi USH harton rregullore të veçantë.

## Neni 5

### Viti akademik

1. Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra. Intervali kohor i viti akademik përcaktohet sipas udhëzimeve të MASH-it dhe me vendim të Rektoratit përcaktohet struktura mësimore e viti akademik e ndarë në javë mësimore dhe javë për provime e riprovime.
2. Çdo fakultet duhet të respektojë me përpikmëri vendimin e Rektoratit lidhur me strukturën mësimore të viti akademik, ta detajojë atë sipas specifikave të fakultetit dhe ta dorëzojë për miratim përfundimtar në Rektorat.

## KREU II

### PRANIMET NË USH

#### Neni 6

##### Pranimet në ciklin e parë të studimeve

1. Çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar Maturën Shtetërore, ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në *ciklin e parë të studimeve* në USH.
2. Ciklin e parë të studimeve në USH mund ta ndjekin edhe studentë të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.
3. Numri i të drejtave të studimit në çdo program studimi në USH,

për çdo vit akademik, për të gjitha sistemet e studimit, propozohet nga Rektorati dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave.

4. Për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve USH ka të drejtë të përcaktojë kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar maturën shtetërore. Këto kritere bëhen të njoitura publikisht nga USH, të paktën gjashtë muaj para fillimit të pranimeve të radhës në institucion, së bashku me informacionin e nevojshëm mbi fakultetin përkatës dhe programet e studimit që ofron.
5. Kandidati fiton të drejtën të ndjekë studimet në vitin e parë akademik në programin e studimit të kërkuar, nëse regjistrohet në Sekretarinë mësimore (SM) dhe paguan tarifën e shkollimit sipas afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të MASH-it, në të kundërt ai humbet përfundimisht të drejtën e regjistrimit.
6. Për t'u regjistruar në ciklin e parë të studimeve, studenti paraqet në SM dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimet e MASH-it dhe të USH.
7. Studentët janë të detyruar të shlyejnë të gjitha detyrimet financiare nga fillimi i çdo viti akademik deri në prag të fillimit të sezonit të provimeve të dimrit. Studenti që nuk shlyen detyrimet para sezonit të provimeve të dimrit nuk lejohet të hyjë në asnjë provim e më pas pezullohet për aq kohë sa nuk e shlyen këtë detyrim.
8. Studentët që janë diplomuar në nivelin e parë të studimeve universitare dhe dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi në sistemin me kohë të plotë pranohen sipas udhëzimeve të MASH-it, kësaj Rregulloreje dhe kundrejt tarifave të përcaktuara.

## Neni 7

### Pranimet në ciklin e dytë të studimeve

1. Kriteret për standartet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e *ciklit të dytë* të studimeve dhe rregullat e funksionimit të këtij cikli përcaktohen në rregullore të veçantë të studimeve, bazuar edhe në udhëzimet e MASH. Ato miratohen nga Senati Akademik i USH.

## Neni 8

### Pranimet në ciklin e tretë të studimeve

1. Kriteret për standartet akademike të përzgjedhjes së kandidatëve për t'u pranuar në programet e *ciklit të tretë* të studimeve dhe rregullat e funksionimit të këtij cikli përcaktohen në rregullore të veçantë të studimeve, bazuar edhe në udhëzimet e MASH. Ato miratohen nga Senati Akademik i USH.

## Neni 9

### Cilësimi ”student”

1. Cilësimi ”student” fillon me regjistrimin në USH dhe mbaron me marrjen e diplomës, me largimin ose me përjashtimin nga USH. Gjatë gjithë kësaj periudhe studenti është i detyruar të zbatojë Statutin dhe rregulloret e USH.

## KREU III

### ORGANIZIMI I STUDIMEVE

## Neni 10

### Programet e studimit në USH

1. Programet e studimeve hartohen nga departamentet, shqyrtohen në Këshillin e Fakultetit dhe miratohen nga Senati.
2. Rektorati shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron, para fillimit të aplikimeve për pranime në të.
3. Fakultetet përcaktojnë në çdo program studimi : emërtimin dhe objektivat formuese të programit, tipet e veprimitarive formuese, kreditet për çdo veprimtarit formuese dhe karakteristikat e temës së diplomës.
4. Për qëllim standardizimi, në pëershkrimin e programeve të studimit, njësitetë kryesore mbajnë parasysh udhëzimet e MASH-it
5. Veprimitaritë formuese që karakterizojnë një program studimi ndahen në:
  - *mësim në auditor* (leksione, seminare, ushtrime, laboratore),
  - *studim individual* (studim, punim detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e temës së diplomës etj.)
  - *veprimitari të tjera* (praktika profesionale pranë subjekteve publike apo atyre private).
6. Studenti i fillon dhe i mbaron studimet në një program të caktuar studimi me atë plan mësimor që i është bërë i njojur atij në datën e regjistrimit në sekretarinë mësimore (SM), gjithmonë në qoftë se i kryen detyrimet e planit mësimor në afatin minimal të parashikuar për mbarimin e studimeve në atë program studimi. Në të kundërt, ai u nënshtrohet detyrimeve të reja që lindin nga ndryshimi i planit mësimor.
7. Në fillim të çdo viti titullari i çdo lënde është i detyruar të

paraqesë për miratim në departament programin mësimor, ndërsa çdo fillim semestri planin kalendar dhe planin e seminareve (seanca praktike e laboratorike) shoqëruar me literaturën përkatëse.

## Neni 11

### Programet mësimore

1. Për çdo disiplinë/modul hartohet programi mësimor, i cili përmban emërtimin e disiplinës/modulit, vitin/semestrin, raportin/kohëzgjatjen (ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë tij, leksion, seminar, laboratror, ushtrime etj.), numrin e krediteve, objektivat e disiplinës/modulit, temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik, format dhe metodat e mësimdhënies së disiplinës dhe raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentëve për disiplinën, literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse.
2. Programet mësimore hartohen nga titullarët e disciplinave dhe miratohen nga departamentet përkatëse.
3. Programet mësimore në ciklin e parë të studimeve në formën e studimit me kohë të pjesshme janë të njëjta me ato të sistemit me kohë të plotë.
4. Studenti është i detyruar të përgjigjet për programin mësimor që është miratuar për vitin akademik që ai ndjek.
5. Departamenti është i detyruar të vërë në dispozicion të studentëve programet mësimore të atij viti akademik.

## Neni 12

### Tekstet mësimore

1. Tekstet mësimore të rekomandueshme për pjesën teorike dhe të detyrueshme për seminaret, ushtrimet apo punët laboratorike duhet të miratohen nga departamenti (me propozimin e titullarëve të disciplinave). Këto u bëhen të njohura studentëve

me fillimin e vitit akademik.

## Neni 13

### Kurset e grupet

1. Mësimi dhe kontrolli i dijeve zhvillohet mbi bazën e kursit dhe të grupit.
2. Leksionet zhvillohen në bazë kursi. Në përputhje me kapacitetin e sallave ose me metodën e zhvillimit të leksioneve, kursi mund të ndahet në dy pjesë kur kalon numrin e 120 studentëve.
3. Seminaret apo ushtrimet zhvillohen mbi bazën e grupit. Grupi, si rregull, ka jo më shumë se 30 studentë, por jo më pak se 5 studentë. Në disiplinat me karakter praktik (laboratoret apo praktikat profesionale), si rregull, grupi (kur ka më shumë se 15 studentë) ndahet në dy pjesë.
4. Ndarma në grupe dhe përcaktimi i numrit të studentëve në kurset e leksioneve bëhet me vendim të Rektoratit, sipas propozimit të fakulteteve përkatëse.

## Neni 14

### Registrat

1. Ndarma e studentëve në grupe pasqyrohet në regjistrat e kursit. Ata janë dokumente zyrtare të frekuentimit të mësimit nga studentët dhe i realizimit të tij nga mësimdhënësit. Në regjistrat e kursit evidentohen disiplinat e zhvilluara, oraret përkatëse dhe punonjësit mësimorë që i kanë zhvilluar ato.
2. Mësimdhënësit janë të detyruar të futen në mësim me regjistër dhe ta plotësojnë atë sipas të gjitha rregullave.
3. Regjistrat ruhen tek sekretarja e dekanit e cila është përgjegjëse për mirëmbajtjen, ruajtjen, shpërndarjen në kohë

- dhe mbledhjen e tyre.
4. Humbja e regjistrave ngarkon me përgjegjësi administrative personat përgjegjës.
  5. Për vitin e parë regjistrat plotësohen nga sekretaria mësimore brenda 10 ditëve pas fillimit të vitit akademik, ndërsa përvitet e tjera regjistrat plotësohen 2 ditë para fillimit të vitit akademik.

## Neni 15

### Format e mësimit

1. Në USH format kryesore të mësimit janë :
  - ✓ leksionet,
  - ✓ seminaret,
  - ✓ ushtrimet,
  - ✓ punët laboratorike dhe praktike,
  - ✓ punimet vjetore,
  - ✓ projektet e kursit,
  - ✓ praktikat në terren,
  - ✓ praktikat profesionale,
  - ✓ ekskursionet mësimore,
  - ✓ kontrollet me shkrim e detyrat e kursit,
  - ✓ provimet e kursit,
  - ✓ mbrojtja e tezës së diplomës.
2. Departamentet, me miratim të dekanatit, mund të përcaktojnë edhe forma të tjera të punës mësimore.

## Neni 16

### Frekuentimi

1. Leksionet, si rregull, janë me frekuentim fakultativ. Në disiplina të caktuara, me propozim të titularit të disiplinës dhe

me miratim të departamentit, përcaktohet masa e frekuentimit të detyruar. Ndjekja e seminareve apo e ushtrimeve është e detyruar në masën 75 % të orëve, ndërsa ndjekja e laboratoreve dhe e praktikave të ndryshme është e detyruar në masën 100% të orëve të programit mësimor të disiplinës. Studentët që nuk e plotësojnë këtë masë frekuentimi humbasin të drejtën për t'u futur në provim në atë disiplinë. Ato kanë të drejtë të riprovohen në sezonin e riprovimit. Kjo u bëhet e njohur studentëve që në fillim të vitit akademik.

2. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e mësimeve. Ai hartohet nga secili fakultet në fillim të çdo semestri dhe shpallet një javë para fillimit të mësimeve. Orari duhet të respektohet rigorozisht nga të gjithë studentët dhe pedagogët e fakultetit.
3. Orari mësimor hartohet nën kujdesin e drejtorit të departamentit dhe koordinohet nga dekani i fakultetit. Ai ndërtohet mbi kritere pedagogjike, mbi bazën e harmonizimit të elementeve të veprimitarive formuese dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës për studentët dhe pedagogët. Ngarkesa mësimore për studentët duhet të jetë 20 - 25 orë në javë.
4. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

## Neni 17

### Praktika profesionale

1. Studentët e sistemit me kohë të plotë e kanë të detyrueshme kryerjen e praktikës profesionale kur ajo përfshihet në planet mësimore dhe në strukturën e vitit akademik. Me fillimin e vitit akademik dekanati u komunikon studentëve kohën e kryerjes dhe programin e zhvillimit të saj.
2. Studenti merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet për

realizimin e praktikave profesionale në terren (me përjashtim të shpenzimeve të udhëtimit dhe të një kuote të caktuar për fjetje, që mbulohen nga USH).

3. Në qoftë se studenti rezulton mbetës në praktikat profesionale dhe ato në terren, ai konsiderohet mbetës në këto disiplina të cilat do të shlyhen vetëm në vitin pasardhës.
4. Praktikat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje shtetërore ose private sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës.
5. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit apo ndërmarrjes ku kryen praktikën profesionale.
6. Kohëzgjatja dhe afati i praktikës profesionale përcaktohen në planet mësimore përkatëse.
7. Në bashkëpunim me Rektoratin çdo fakultet përcakton vendet e zhvillimit të praktikës profesionale.
8. Qendrat ku do të zhvillohen praktikat duhet të jenë të miratuara nga organizmat shtetërore përkatëse dhe duhet të kenë detyrime të kontraktuara me USH-në.
9. Në përfundim të praktikës profesionale (vetëm praktika në terren), studenti përgatit një relacion për punën e kryer, i cili vlerësohet nga pedagogët që e drejtojnë praktikën. Vlerësimi bëhet me notë.

## Neni 18

### Studimet me kohë të pjesshme

1. Organizimi dhe zhvillimi i studimeve me kohë të pjesshme bëhet duke u mbështetur në këto kritere :
  - Pranimi i kandidatëve në sistemin me kohë të pjesshme bëhet sipas udhëzimeve të MASH-it.
  - Departamenti dhe fakulteti ku organizohen studimet me kohë të pjesshme, me miratim të Rektoratit, përcaktojnë :

strukturën mësimore, mënyrën e zhvillimit të mësimeve, afatet e mënyrën e shlyerjes së detyrimeve etj. Të gjitha këto u bëhen të njohura kandidatëve në fillim të vitit akademik;

2. Për këtë sistem studimi USH harton rregullore të veçantë.

## Neni 19

### Studimet e dyta

1. USH ofron mundësinë e kryerjes së studimeve të dyta në ciklin e parë të studimeve pas përfundimit me sukses të studimeve në një nga fushat e diplomimit të këtij Universiteti apo jashtë tij. Pranimi bëhet duke u mbështetur në kuotat e miratuara nga Këshilli i Ministrave Kriteret mbi të cilat bazohen këto studime janë:
  - Pranimi i kandidatëve bëhet sipas udhëzimeve të MASH-it mbi bazën e kritereve seleksionuese të meritës, të përcaktuara nga USH dhe kundrejt tarifës së caktuar.
  - Komisioni i Njohjes së Ekuivalentimit të Studimeve në nivel fakulteti përcakton detyrimet që duhet të përballojë kandidati për studimet bazë dhe vendimi i marrë prej tij, pasi miratohet nga dekani, i jepet SM-së për veprim.

## Neni 20

### Transferimet

1. USH pranon transferime studentësh në vite të ndërmjetme nga universitete të tjera, në të njejtin sistem e program studimi dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në këtë “Rregullore”.
2. Studentët duhet të kenë përfunduar vitin e parë, duke fituar të paktën 30 kredite.

3. Transferimi bëhet i mundur vetëm pas njohjes së rezultateve të studimit dhe pas ekuivalentimit.
4. Procedurat transferuese përfundojnë 15 ditë para fillimit të vitit akademik.
5. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon strukturës mësimore që pranon studentin sipas kritereve të përcaktuara në Statut dhe në këtë Rregullore.
6. Njësitë kryesore pritëse të USH vendosin kriterë specifike, në varësi të formës së studimit dhe të programit përkatës të studimit dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.
7. Njësitë kryesore pritëse të USH ngrajnë komisione *ad hoc* të transferimeve me anëtarë të personelit akademik për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me kriteret e vendosura, si edhe njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara prej tyre në programet apo vitet e mëparshme të studimit.
8. Studentë të USH, të cilët duan të transferohen në universitetet të tjera të vendit, në të njëjtin sistem e program studimi i paraqesin një kërkesë dekanit të fakultetit ku ata kryejnë studimet. Nëse kjo kërkesë miratohet, dekani ia paraqet kërkesën Rektoratit, i cili, pasi merr vendimin miratues, ua përcjell propozimin universiteteve pritëse. Pas përgjigjes së pranimit nga universiteti pritës, përcillet dokumentacioni i plotë i studentit (fusha e studimit, kursi, sistemi i studimit, detyrimet e shlyera dhe notat përkatëse, kreditet e fituara, certifikata e gjendjes civile me fotografi, nëse gjzon të drejtën e bursës ose jo, programet e disiplinave që ka kryer).
9. Për studentët e universiteteve të tjera, që duan të transferohen në USH në të njëjtin sistem e program studimi, propozimet vijnë nga Rektorati i universitetit përcjellës, shoqëruar me të dhëna të hollësishme për studentin (dega, kursi, sistemi i

- studimit, detyrimet e shlyera dhe notat përkatëse, kreditet e fituara, certifikata e gjendjes civile me fotografi, nëse gjzon të drejtën e bursës ose jo, programet e disiplinave që ka kryer). Vendimin për pranimin e studentëve të propozuar për transferim e merr Rektorati, pasi ka marrë mendimin e dekanit të fakultetit përkatës, duke patur parasysh mundësitetë dhe kapacitetin e programit të studimit (deri në 5% të numrit të pranimeve të reja të vitit), si dhe rezultatin e ekuivalentimit.
10. Studentët, të cilëve u miratohet transferimi nga Universiteti ynë, janë të detyruar të paguajnë tarifën e çregjistrimit.

## Neni 21

### Njohja e shlyerjes me ekuivalencë

1. Për studentët që transferohen në USH, komisioni i njohjes dhe i ekuivalentimit, i ngritur pranë çdo njësie bazë, mbi bazën e dokumenteve që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet sipas planit mësimor në fuqi dhe vendimi i marrë nga ky komision i jepet sekretarisë mësimore për veprim.
2. Njohja e shlyerjes së disiplinave me ekuivalencë bëhet nga komisioni i ngritur pranë departamentit përkatës edhe për të gjitha rastet e tjera të nevojshme.

## Neni 22

### Ndërrimi i sistemit të studimeve

1. Kalimi i studentëve nga sistemi i studimeve me kohë të plotë në sistemin e studimeve me kohë të pjesshme, për profile studimesh që mbulon fakulteti, bëhet me vendim të Rektoratit, pas propozimit të dekanit të fakultetit përkatës. Kjo lëvizje bëhet me kërkesë të studentit të interesuar, pasi ai të ketë përfunduar vitin e parë.
2. Në rastet e kalimeve të përmendura më sipër nuk duhet të cënohen kuotat e studentëve të kurseve përkatëse të caktuara

nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

3. Kërkesat, së bashku me dokumentacionin përkatës, dorëzohen pranë dekanateve deri 20 ditë para fillimit të vitit akademik. Vendimi i Rektoratit për këto kalime bëhet deri 5 ditë para fillimit të vitit të ri akademik.
4. Kur procedura ka përfunduar, studenti nuk ka të drejtë të kthehet më në sistemin e mëparshëm.
5. Studenti që ndryshon sistemin e studimeve diplomohet në sistemin ku ai mbyll përfundimisht studimet.

## KREU IV

### KONTROLLI I DIJEVE

Neni 23

#### Sistemi i vlerësimit

1. Vlerësimi i përparimit të studentëve bëhet me notë.
2. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Nota më e ulët për kalim në një disciplinë është 5.
3. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet detyrimisht në notë.
4. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë : vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disciplinës/modulit dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit përfaqëson 20 - 40 % të vlerësimit përfundimtar. Përcaktimi i raporteve në mes të vlerësimit të

vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga çdo pedagog dhe paraqitet në programin e disciplinës/modulit.

5. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit duhet t'i llogaritet studentit vetëm në sezonin e provimit e jo në sezonin e riprovimit. Në sezonin e riprovimit vlerësimi përfundimtar i studentit do të përbëhet vetëm nga vlerësimi në provim.
6. Kur disciplina është e ndarë në module, në fund të çdo moduli organizohet shlyerja e tij (duke respektuar pikën 4 të këtij nenit). Shlyerja e tyre duhet të jetë e pasqyruar në programin mësimor. Në përfundim të shlyerjes së modulit të veçantë, ai vlerësohet me notë më vete dhe nota hidhet në një procesverbal të veçantë. Kur shlyhen të gjitha modulet e disciplinës ato pasqyrohen në procesverbalin përfundimtar që përmban notat e moduleve të veçanta dhe notën përfundimtare, e cila shprehet me notën mesatare të ponderuar. Nota përfundimtare hidhet në regjistrin e notave nga SM.
7. Në rast se studenti shpallet mbetës të paktën në njërin nga modulet gjatë shlyrjes së tyre, lëndë nuk konsiderohet e shlyer. Atij nuk i llogariten pikët kredite (ECTS) e modulit të shlyer për llogari të vitit pasardhës. Studenti ka të drejtë të shlyejë modulet në sezonin e provimeve ose në sezonet e tjera. Provimi i disciplinës së ndarë në module organizohet në datën e paracaktuar në orarin e provimeve në një sallë, ku studenti ka të drejtë që brenda kohës së përcaktuar në rregullore të zhvillojë të gjitha modulet e pashlyera. Pas vlerësimit të sëcilit modul me notë më vete, nota hidhet në një procesverbal të veçantë. Kur shlyhen të gjitha modulet e disciplinës ato pasqyrohen në procesverbalin përfundimtar që përmban notat e moduleve të veçanta dhe notën përfundimtare, e cila shprehet me notën mesatare të ponderuar. Nota përfundimtare hidhet në regjistrin e notave nga SM.

## Neni 24

### Parakushtet për hyrjen në provim

1. Studenti lejohet të hyjë në provimin e një lënde kur ka frekuentuar në masën e caktuar seminaret, ushtrimet, laboratoret e praktikat e ndryshme, (sipas nenit 16).
2. Në rast moslikuidimi të laboratoreve studenti shpallet mbetës në disiplinën përkatëse. Studentit që ka shlyer jo më pak se 60% të punëve të laboratorit, i krijohet mundësia t'i shlyjë punët e laboratorit të mbeturës në një periudhë kohore të përcaktuar nga departamenti përkatës para sezonit të riprovimit të vjeshtës. Studentët e tjera i shlyejnë ato në vitin e ardhshëm.
3. Punët laboratorike dhe pjesa teorike vlerësohen së bashku vetëm me një notë.
4. Studentit i lind e drejta e hyrjes në provim, mbasi pedagogu i disiplinës t'ia ketë komunikuar atij këtë të drejtë në orën e fundit të mësimit.
5. Pedagogët dorëzojnë në departament listën e studentëve që kanë detyrim. Drejtori i departamentit dorëzon në SM listën e studentëve që për arsyesh detyrimet nuk hyjnë në provim. SM pasqyron në procesverbalin e provimit vetëm emrat e studenteve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e disiplinës/modulit.
6. Prosesverbal i provimit përgatitet nga SM, nënshkruhet nga sekretarja përkatëse e SM dhe dekani. Ky procesverbal mban vulën e dekanit të fakultetit. Çdo procesverbal duhet të merret me firmë nga pedagogu i disiplinës/modulit dhe duhet të dorëzohet me firmë.

## Neni 25

### Format e kontrollit

1. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e dijeve të studentit gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një disipline/moduli janë provimi dhe forma të tjera të vlerësimit.
2. Format e kontrollit të dijes përcaktohen në programin e disiplinës/modulit dhe në planin mësimor të studimeve.
3. Mënyra e zhvillimit të provimit mund të jetë :
  - a. me shkrim,
  - b. me zë,
  - c. kombinuar (me shkrim e me zë). Në këtë rast departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit është përcaktuese apo eleminuese.
4. Mënyra e zhvillimit të provimit propozohet nga titullari i disiplinës e miratohet nga departamenti në fillim të çdo viti akademik.
5. Tezat e provimit hartohen nga titullari/titullarët i disiplinës/modulit. Organizimi dhe drejtimi i vlerësimit të dijeve bëhet nga Drejtori i Departamentit.

## Neni 26

### Provimi i kursit

1. Provimet e kursit zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në strukturën e vittit akademik. Datat e provimeve hartohen nga departamentet, miratohen nga dekani dhe shpanllen jo më vonë se katër javë nga fillimi i semestrit.
2. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar (për arsyesh madhore), drejtori i departamentit merr masat për zhvillimin normal të tij.
3. Studentët merren në provimin e disiplinës/modulit në prani të titullarëve të disiplinës/modulit me jo më pak se dy pedagogë.

Nëse një nga titullarët disiplinës/modulit (për arsyen madhore) nuk mund të marrë pjesë në provim, drejtori i departamentit krijon një komision të ri për zhvillimin normal të provimit.

4. Kur provimi është ***vetëm me shkrim*** :

- Për disiplinat që kanë teori, ushtrime ose seminare, përpilohen aq teza sa të përbajnë pyetje lidhur me teorinë dhe praktikën e të gjithë disiplinës së zhvilluar.
- Zgjedhja e tezës bëhet nga një student prezent në sallën e provimit. Provimi zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është drejtori i departamentit ose një person i autorizuar nga ai.
- Kohëzgjatja e provimit është 2-3 orë.
- Korrigjimi i fletoreve bëhet nga komisioni i provimit. Në përfundim të tij bëhet çsekretimi. Rezultatet u bëhen të njohura studentëve 3-5 ditë pas zhvillimit të provimit. Komisioni bën ballafaqimin me studentët ditën e caktuar të dhënies së rezultateve.
- Vlerësimi përfundimtar përbëhet nga 60-80 pikë në sezonin e provimit dhe nga 100 pikë në sezonet e riprovimeve. Minimumi për kalim është 45 pikë. Kur teza e provimit është ndërtuar në dy pjesë (teori dhe ushtrime), në secilën pjesë studenti duhet të fitojë jo më pak se 20 pikë.
- Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës.
- Përgjigjet e studentëve duhet të ruhen pranë departamentit deri në mbarim të sezonit pasardhës.

5. Kur provimi është ***vetëm me gojë*** :

- Titullari i disiplinës harton aq teza sa të përfshihet e gjithë lënda.
- Teza zgjidhet nga vetë studenti.
- Vlerësimi bëhet me notë.
- Kohëzgjatja e provimit është jo më shumë se 30 minuta

për çdo student.

- Rezultati i jepet studentit menjëherë pas përgjigjes, duke u hedhur domosdoshmërisht në librezën e notave.

6. Kur provimi zhvillohet ***me shkrim dhe me gojë***:

- ndiqen të njëjtat rregulla si më sipër.
- Më parë zhvillohet provimi me shkrim.
- Kusht për të hyrë në provimin me gojë është që studenti të fitojë të paktën 35 pikë.

7. Studenti paraqitet në provim vetëm me librezën e studentit.

8. Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjera të grupit apo të kursit përkatës.

9. Nuk lejohet hyrja në sallën ku zhvillohet provimi i personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të Universitetit, me përjashtim të drejtorit të departamentit, dekanit të fakultetit, përfaqësuesve të Rektoratit dhe personave të tjera të autorizuar me shkrim nga dekani ose Rektori për të kryer kontroll.

10. Pas dhënies së rezultateve të provimit, komisioni është i detyruar të vërë notën në librezën e studentit.

11. Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikëqyrin zhvillimin korrekt të tij. Në qoftë se gjatë zhvillimit të provimit, studentët në sallë ose persona të jashtëm nuk lejojnë kryerjen me rregull të tij, komisioni ka të drejtë të ndërpresë provimin dhe të kërkojnë ndihmën e të gjitha instancave (deri tek organet e ruajtjes së rendit publik) për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit. Për këtë lajmëron menjëherë dekanin, i cili cakton një datë tjetër të zhvillimit të provimit. Në këtë rast provimi bëhet vetëm me shkrim. Studentët që deri në atë çast e kanë kryer provimin me gojë, nuk provohen më.

12. Procesverbalet e përfundimit të provimit dorëzohen tek SM.

13. Nuk lejohet përsëritja e një provimi brenda së njëjtës periudhë

- të sezonit.
14. Nuk lejohet dhënia e më shumë se një provimi në të njëjtën ditë.
  15. Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se janë shkelur rregullat proceduriale të zhvillimit të provimit. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, duke iu drejtuar dekanit të fakultetit. Dekani vlerëson ankesën dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj "Rregulloreje", me propozimin e drejtorit të departamentit, dekan vendos për ndryshimin e komisionit dhe për ridhënien e provimit ose kolokiumit brenda ditës ose të nesërmén.
  16. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtorit të departamentit me një ankesë me shkrim. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin të rivlerësojë edhe një herë testin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Ky vendim është i formës së prerë.
  17. Studentët që nuk kanë mundur të informohen në kohë mbi rezultatet e provimit kanë të drejtë të informohen pranë SM.

### Neni 27

#### **Sezonet e zhvillimit të provimeve të kursit**

1. Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 3 sezone:
  - a. **sezoni i dimrit**, *në përfundim të semestrit të parë*, që përbëhet nga dy periudha, periudha e parë e provimit dhe periudha e dytë e provimit. Në periudhën e parë të provimit studentët do të provohen për disiplinat e semestrit të parë (lëndë të semestrit të parë të vitit aktual që ndodhet studenti) dhe në periudhën e dytë të provimit studentët kanë të drejtë të riprovohen në ato disciplina në të cilat kanë rezultuar mbetës në sezonin e vjeshtës, por që i takojnë semestrin të dytë të vitit paraardhës.
  - b. **sezoni i verës**, *në përfundim të semestrit të dytë*, që përbëhet nga dy periudha, periudha e parë e provimit dhe periudha e dytë e provimit. Në periudhën e parë të provimit studentët do të provohen për disiplinat e semestrit të dytë (lëndë të semestrit të dytë të vitit aktual që ndodhet studenti) dhe në periudhën e dytë të provimit studentët kanë të drejtë të riprovohen në ato disciplina në të cilat kanë rezultuar mbetës në periudhën e parë të sezonit të dimrit.
  - c. **sezoni i vjeshtës**, ku studentët mund të riprovohen në ato disciplina në të cilat kanë rezultuar mbetës në sezonet e dimrit dhe të verës. Numri i provimeve që mund të shlyejnë studentët në sezonin e vjeshtës do të jetë jo më shumë se 6 (gjashtë) provime, qofshin këto të vitit apo të mbartur.
2. Studenti ka të drejtë të përmirësojë jo më shumë se dy disciplina të zhvilluara vetëm në atë vit akademik. Për këtë studenti duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë dekanatit përkatës, duke përcaktuar saktë disiplinat për të cilat dëshiron të riprovohet për t'i përmirësuar.
3. Për dhënien e provimeve të mbeturë studenti duhet të regjistrohet pranë SM, duke paraqitur kërkesë me shkrim deri në 3 (tri) ditë para zhvillimit të provimeve.

### Neni 28

#### **Studenti mbetës në provimin e një lënde**

1. Studenti, që për çfarëdo arsyje nuk paraqitet në provimin ose në mënyrat e tjera të vlerësimit konsiderohet mbetës. Gjithashtu, studenti vlerësohet mbetës kur:
  - tërhiqet nga provimi,

- kopjon,
- mashton me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai nxirret jashtë nga provimi).

### Neni 29

#### **Studenti kalues i një kursi**

1. Studenti për të kaluar në vitin pasardhës, duhet të ketë grumbulluar nga viti që ndjek të paktën 30 pikë kredite.
2. Në 30 pikët kredite (ECTS) nuk përfshihen ECTS e moduleve të veçanta në rastet kur nuk janë shlyer të gjitha modulet e disiplinës, pra kur nuk është shlyer disciplina.

### KREU V

### DIPLOMIMI

### Neni 30

#### **Diplomimi**

1. Studenti në përfundim të kursit të plotë të studimeve ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës profesional, në qoftë se ai ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në planin mësimor.
2. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze.
3. Departamentet përcaktojnë fushat dhe komisionet e mbrojtjes së tezave në fillim të semestrit të parë të vitit të fundit të studimeve. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.
4. Drejtuesit e tezave miratohen nga departamenti.
5. Diplomimi bëhet në tre sezone : në sezonin e dimrit, në sezonin e verës dhe në sezonin e vjeshtës.

### Neni 31

#### **Mbrojtja e diplomës**

1. Komisionet e mbrojtjes së tezës së diplomës përbëhen nga jo më pak se 2 pedagogë të fushave të përafërtë dhe kryetarët e komisioneve. Ato miratohen nga dekani i fakultetit, sipas propozimit të departamenteve
2. Mbrojtja e tezës së diplomës bëhet e hapur. Ajo bëhet pasi të jetë plotësuar dhe dorëzuar pranë departamentit dokumentacioni i mëposhtëm :
  - Teza e diplomës dorëzohet në department jo më vonë se 2 javë para ditës së caktuar përmes mbrojtje. Ajo duhet të përbajë jo më pak se 15 faqe.
  - Tabela e vlerësimit të studentëve në provimet e kursit me pikë kredite (e përgatitur nga sekretaria mësimore përkatëse).
  - Vërtetim nga të gjitha strukturat administrative të USH (biblioteka, dega ekonomike, dega e financës, etj.) që studenti nuk është debitor ndaj Universitetit.
  - Prosesverbali i mbrojtjes së tezës së diplomës në 2 kopje.
3. Mbrojtja e tezës së diplomës organizohet sipas kësaj Procedure :
  - Studenti prezanton tezën e vet para komisionit.
  - Komisioni bën pyetje rrith tezës së diplomës, kandidati përgjigjet.
  - Në prani të kandidatit dhe të gjithë anëtarëve të komisionit, kryetari shpall vendimin mbi vlerësimin e diplomantit.

## Neni 32

### Pajisja me diplomë

1. Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur tezën e diplomës pajiset me diplomën përkatëse, shoqëruar me fletën e notave dhe me diplomën suplement.
2. Diploma plotësohet me shkrim, qartë dhe me bojë teknike nga komisioni përkatës.
3. Tërheqja e diplomës bëhet nga vetë i diplomuari kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit për arsyen madhore është objektivisht e pamundur, tërheqja e diplomës mund të bëhet nga një person i pajisur me prokurë të posaçme, duke paraqitur dokument identifikimi.
4. Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari nuk duhet ta tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Nëse i interesuari e tërheq diplomën e parregullt, në rast se i humbet, i dëmtohet apo i bëhet e papërdorshme ajo, Universiteti nuk lëshon dublikatë.
5. Për raste të veçanta lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara dhe vërtetimi me fotografi, i cili është ekivalent me diplomën, pasi të nënshkruhet nga sekretari mësimor i SM-së, dekani i fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Nënshkrimi i Rektorit shoqërohet me vulën e Universitetit.

## Neni 33

### Dorëzimi i diplomave

1. Dorëzimi i diplomave për të gjithë studentët bëhet me ceremoni pranë çdo fakulteti.
2. Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta jepet medalje e artë dhe certifikata përkatëse. Medalja e arit dhe emri i tij regjistohen në Librin e Universitetit.
3. Për studentët që gjatë studimeve kanë marrë mbi 80 % të notave

dhjeta dhe pjesën tjeter vetëm nënta, jepet certifikata “*Student i shkëlqyer*”.

4. Në këto raste Universiteti organizon ceremoni të veçantë.

## KREU VI

### TË DREJTAT E DETYRIMET E STUDENTIT

## Neni 34

### Të drejtat dhe detyrat e studentit

1. Studenti ka të drejtë:

- a. Të përdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësítë dhe pajisjet që ofron shkolla për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor.
- b. Të përfitojë bursë studimi brenda ose jashtë shtetit, kur plotëson kushtet e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të Senatit ose në marrëveshjet ndërshtetërore apo ndëruniversitare.
- c. Të përfitojë shpërblime të veçanta që administrohen dhe akordohen nga USH sipas ligjit dhe kritereve të caktuara nga Senati.
- d. Studenti ka të drejtë të përmirësojë çdo vit mësimor dy nota, me kusht që disiplinat përkatëse të janë vetëm nga detyrimet e atij viti. Studenti provohet vetëm një herë për përmirësim note dhe vetëm në sezonin e riprovimeve të vjeshtës. Mbetet në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund. Kërkesa për përmirësim note paraqitet me shkrim pranë dekanatit përkatës para sezonit të riprovimeve.
- e. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave

- të zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin e tij të pamerrituar. Ankesa me shkrim i paraqitet përgjegjësit të departamentit menjëherë pas marrjes së rezultatit të provimit.
- f. Studentit prapambetës i njihen të gjitha detyrimet e shlyera në vitet paraardhëse.

2. Studenti është i detyruar :

- a. Të njohë dhe të zbatojë të gjitha rregullat që rrjedhin nga Statuti i Universitetit, nga kjo “*Rregullore*” dhe nga çdo akt tjeter ligjor e nënligjor. Në të kundërt USH nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- b. Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor dhe në programet e disiplinave të veçanta.
- c. Të zhdëmtojë, sipas rregullave në fuqi, të gjitha dëmtimet e vlerave materiale të kryera prej tij.
- d. Të mos përfitojë burse në rastet kur përsërit vitin.
- e. Të shlyejë detyrimet e reja (kur student është përsëritës) që lindin për shkak të ndryshimeve që mund të jenë bërë në planin mësimor
- f. Të zbatojë të gjitha rregullat e etikës. Shkelje të rregullave të etikës konsiderohen :
  - të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që cënojnë personalitetin e pedagogut, të çdo punonjësi tjeter të USH apo të një studenti tjeter;
  - normat etiko-morale të shoqërisë (kopjimi në provime, falsifikimi i dokumenteve të ndryshme zyrtare etj., aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes etj.) Këto veprime konsiderohen shkelje të rregullave të etikës, (kur nuk mbartin elemente të veprës penale) dhe ndaj studentit merren këto masa disiplinore :
    - Vërejtje me shkrim,
    - Përjashtim nga shkolla për një vit. Vendimin për

përjashtimin e studentit një vit nga shkolla e merr Këshilli i Fakultetit.

- Përjashtim nga USH (heqje e së drejtës të studimit të fituar). Vendimin për përjashtimin nga Universiteti e merr Këshilli i Etikës së Universitetit mbi bazën e propozimit të Dekanatit të Fakultetit.

## KREU VII

### DISPOZITA TË VEÇANTA

#### Neni 35

Kjo “*Rregullore*” shtrin veprimtarinë, duke filluar nga viti akademik 2009-2010.

#### Neni 36

Të drejtën e patjetërsueshme për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Rektorati i Universitetit të Shkodrës “*Luis Gurakuqi*”.

Miratuar me vendim nr. 190/1, datë 26.10. 2009 të Senatit të Universitetit të Shkodrës “*Luis Gurakuqi*”.



*Shkodër, tetor 2009*